



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 13.11.2018

Dokument parlamentar

RAPORT PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9975, DATË 28.7.2008, “PËR TAKSAT KOMBËTARE”, TË NDRYSHUAR

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar”, në mbledhjen e datës 6, 8 dhe 11 nëntor 2018.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’u dhënë shpjegime pyetjeve të deputetëve, ishin përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave. Paketa fiskale u prezantua nga zv/Ministri i Ekonomisë dhe Financave z. Luçi.

1. Qëllimi i projektligjit

Projektligj ka si qëllim të rishikojë skemën e taksimit të ambalazheve të plastikës dhe të qelqit si dhe propozon rritjen e rentës për eksportin e mineralit të kromit të papërpunuar.

Projektligji propozon edhe rritjen e rentës minerare për kromin. Kjo bazuar në përlllogaritje të cilat çojnë në përfundimin që nëse rezervat e njohura të kromit shfrytëzohen me një intensitet të tillë duke eksportuar pjesën dërmuese të tij në formë të papërpunuar, industria e ferrokromit në Shqipëri duhet të mbyllet brenda një 10 vjeçari.

Gjithashtu, projektligji propozon heqjen e taksës së karbonit për sasitë e benzinës dhe gazoilin që eksportohen. Duke qenë se taksa e karbonit aplikohet për të detyruar përdoruesit e lëndëve djegëse që të paguajnë për dëmet që i shkaktojnë ajrit nëpërmjet çlirimit të dioksidit të karbonit në atmosferë dhe gjithashtu për të motivuar përdorimin e energjisë së pastër.

2. Argumentimi për ndryshimin

Nga të dhënat statistikore, vetëm 9-10 % e taksës nga ambalazhi plastik arkëtohet nga prodhimi vendas, ndërkohë që 90-91 % e taksës nga ambalazhi plastik arkëtohet nga importi.

Diferencimi i taksimit mes ambalazheve plastike që importohen dhe atyre që prodhohen në vend nga riciklimi është kritikuar nga strukturat e Bashkimit Evropian. Ky diferencim është 1 me 100.

Ky diferencim në taksim ka çuar drejt informalitetit në këtë sektor pasi prodhuesit deklarojnë sasi minimale prodhimi të ambalazhit plastik që ka taksë 100 lekë/kg, dhe deklarojnë lëndë e parë plastike “jo ambalazh”, që nuk ngarkohet me këtë taksë.

Gjithashtu, industria e prodhimit të ujit, ku ambalazhi plastik përbën 51 % të kostos, prodhimi i ujit nga operatorë të cilët furnizohen me ambalazh plastik nga prodhues vendas që nuk e raportojnë si të tillë dhe nuk paguajnë taksën për të, krijon konkurrencë jo të ndershme dhe informalitet në këtë sektor.

3. Ndryshimet e propozuara

I. Projektligji propozon rritjen e skemës së taksimit të ambalazhit. Ndryshimi i propozuar synon që për prodhimin brenda vendit të materialeve plastike, të vendoset taksa mbi lëndët e para në formë primare që importohen dhe përdoren për prodhimin e mallrave plastike në nivelin 25 lekë/kg, përfshirë ambalazhin, me qëllim që të mos taksohet thjesht ambalazhi, por materiali, qoftë ambalazh, qoftë produkt tjetër plastik. Ndryshimi i propozuar çon në shfuqizimin e taksës simbolike 1 lekë/kg për ambalazhet e prodhuara nga riciklimi, ndërkohë që për materialet plastike që riciklohen taksa merret në momentin kur importohen. Edhe kjo taksë është ulur në 35 lekë/kg nga 100 lekë/kg që ishte më parë.

II. Projektligji propozon rritjen e rentës minerare të kromit që eksportohet për të dekurajuar eksportin e mineralit krom të papërpunuar duke stimuluar kështu përpunimin e mineralit në vend me qëllim rritjen e vlerës së tij për eksport.

III. Projektligji propozon heqjen e taksës së karbonit për sasitë e benzinës dhe gazoilit që eksportohen. Prodhimi shqiptar nuk është i konkurrueshëm pasi taksohet edhe në Shqipëri në momentin e eksportit edhe në vendin e destinacionit, pra, për të njëjtin produkt kemi një taksim të dyfishtë. Kjo është aplikuar edhe për taksën e qarkullimit për benzinën dhe gazoilin për sasitë që eksportohen.

4. Grupet e interesit

Gjatë diskutimit të paketës fiskale Komisioni zhvilloi një seancë dëgjimore me grupet e interesit si Shoqata Shqiptare e Investitorëve të Huaj (FIAA), Shoqata Kombëtare e Transportit Qytetas, Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë, Shoqata e Ricikluesve

- **Shoqata e Ricikluesve**

Shoqata e ricikluesve shprehu shqetësimin e saj në lidhje me taksën e ambalazhit dhe të lëndës së parë të granular plastike. Ata u shprehën që biznesi i tyre rëndohet dy herë tashmë prej kësaj takse, konkretisht me taksën e lëndës së parë prej 25lekë/kg, si dhe me taksën e ambalazheve dhe produkteve që prodhojnë me të dhe eksportojnë.

Gjithashtu, kërkuar reduktimin e taksës së lëndës së parë nga 25 lekë/kg në 10 lekë/kg.

- **Shoqata Shqiptare e Investitorëve të Huaj (FIAA)**

Ky grup shprehu shqetësimin e tij në lidhje me vendosjen e akcizës prej 1 lekë/kg për zhavorrin bituminoz duke argumentuar që kjo përbën rreth 32% të çmimit të produktit dhe kjo rritje do të bëjë që fabrikat e çimentove që janë përdorues të zhavorrit bituminoz të drejtohen drejt produkteve të tjera siç është koksi i naftës, si dhe do të çojë drejt mbylljes bizneset që operojnë në karrierat e Selenicës.

Gjithashtu, shprehën shqetësim për rritjen e rentës së kromit nga 6 në 9%. Duke qenë se kapaciteti përpunues në vend është i kufizuar, kjo bën që tepërsit të drejtohen importit duke u bërë kështu subjekt i një rente prej 9%. Sipas Shoqatës kjo do të bëjë që të ulët sasia e nxjerrjes së kromit duke penalizuar më shumë subjektet e vogla të nxjerrjes së kromit.

5. Diskutimet në Komision

Diskutimet në Komision u fokusuan tek mundësia e një dispozite që parashikon rimbursimin në eksport të ambalazheve dhe materialeve të prodhuara nga lëndë të para plastike primare për të cilat është paguar taksa prej 25 lekë/kg, si dhe efektin që do të kishte ky ndryshim në përmirësimin e klimës së biznesit.

Me qëllim pastrimin e mjedisit nga mbetjet plastike, deputetët diskutuan edhe mbi mundësinë e një mekanizmi për stimulimin e grumbullimit të këtyre mbetjeve duke propozuar një stimul financiar prej 10 mijë lekë për ton, i cili do t'u shpërndahet grumbulluesve të tyre.

Gjithashtu, deputetët diskutuan për mundësinë e vendosjes së një kalendari për rritjen graduale të rentës së kromit me nga 1% përgjatë 3 viteve në vazhdim, duke krijuar një mundësi për rritjen e parashikueshmërisë së politikave fiskale për biznesin, dhe nxitjen e investimeve brenda vendit.

Deputetët shprehën shqetësimin edhe për përqindjen e ulët të të ardhurave nga renta që kalojnë në administrim të pushtetit vendor në zonat ku janë të vendosura industritë nxjerrëse.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni me shumicë votash e miratoi projektligjin në parim dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare. Deputetët e opozitës nuk ishin të pranishëm.

Ilir BEQAJ

Eduard SHALSI

Relator

Kryetar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 23.11.2018

Dokument parlamentar

RAPORT

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9975, DATË 28.7.2008, “PËR TAKSAT KOMBËTARE”, TË NDRYSHUAR (shqyrtimi nen për nen)

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi nen për nen projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar”, në mbledhjen e datës 23 nëntor 2018.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit ishin përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar”, u miratua në parim në seancën e datës 22 nëntor 2018.

• **Ndryshimet e kryesore që parashikon projektligji**

I. Ndryshimin e skemës së taksimit të ambalazhit. Ndryshimi i propozuar synon që për prodhimin brenda vendit të materialeve plastike, të vendoset taksa mbi lëndët e para në formë primare që importohen dhe përdoren për prodhimin e mallrave plastike në nivelin 25 lekë/kg, përfshirë ambalazhin, me qëllim që të mos taksohet thjesht ambalazhi, por materiali, qoftë ambalazh, qoftë produkt tjetër plastik. Ndryshimi i propozuar çon në shfuqizimin e taksës simbolike 1 lekë/kg për ambalazhet e prodhuara nga riciklimi, ndërkohë që për materialet plastike që riciklohen taksa merret në momentin kur importohen. Edhe kjo taksë është ulur në 35 lekë/kg nga 100 lekë/kg që ishte më parë.

II. Rritjen e rentës minerare të kromit që eksportohet për të dekurajuar eksportin e mineralit krom të papërpunuar duke stimuluar kështu përpunimin e mineralit në vend me qëllim rritjen e vlerës së tij për eksport.

III. Heqjen e taksës së karbonit për sasi të benzinës dhe gazoilit që eksportohen. Prodhimi shqiptar nuk është i konkurrueshëm pasi taksohet edhe në Shqipëri në momentin e eksportit edhe në vendin e destinacionit, pra, për të njëjtin produkt kemi një taksim të dyfishtë. Kjo është aplikuar edhe për taksën e qarkullimit për benzinën dhe gazoilin për sasi të që eksportohen.

1. Grupet e interesit

Gjatë diskutimit të paketës fiskale Komisioni zhvilloi një seancë dëgjimore me grupet e interesit si Shoqata Shqiptare e Investitorëve të Huaj (FIAA), Shoqata Kombëtare e Transportit Qytetas, Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë, Shoqata e Ricikluesve.

- **Shoqata e Ricikluesve**

Shoqata e ricikluesve shprehu shqetësimin e saj në lidhje me taksën e ambalazhit dhe të lëndës së parë të granuluar plastike. Ata u shprehën që biznesi i tyre rëndohet dy herë tashmë prej kësaj takse, konkretisht me taksën e lëndës së parë prej 25 lekë/kg, si dhe me taksën e ambalazheve dhe produkteve që prodhojnë me të dhe eksportojnë.

Gjithashtu, kërkuar reduktimin e taksës së lëndës së parë nga 25 lekë/kg në 10 lekë/kg.

- **Shoqata Shqiptare e Investitorëve të Huaj (FIAA)**

Ky grup shprehu shqetësimin e tij në lidhje me vendosjen e akcizës prej 1 lekë/kg për zhavorrin bituminoz duke argumentuar që kjo përbën rreth 32% të çmimit të produktit dhe kjo rritje do të bëjë që fabrikat e çimentove që janë përdorues të zhavorrit bituminoz të drejtohen drejt produkteve të tjera siç është koksi i naftës, si dhe do të çojë drejt mbylljes bizneset që operojnë në karrierat e Selenicës.

Gjithashtu, shprehën shqetësim për rritjen e rentës së kromit nga 6 në 9%. Duke qenë se kapaciteti përpunues në vend është i kufizuar, kjo bën që tepërsit të drejtohen importit duke u bërë kështu subjekt i një rente prej 9%. Sipas Shoqatës kjo do të bëjë që të ulët sasia e nxjerrjes së kromit duke penalizuar më shumë subjektet e vogla të nxjerrjes së kromit.

2. Diskutimet në Komision

Diskutimet në Komision u fokusuan tek mundësia e një dispozite që parashikon rimbursimin në eksport të ambalazheve dhe materialeve të prodhuara nga lëndë të para plastike primare për të cilat është paguar taksa prej 25 lekë/kg, si dhe efektin që do të kishte ky ndryshim në përmirësimin e klimës së biznesit.

Me qëllim pastrimin e mjedisit nga mbetjet plastike, deputetët diskutuan edhe mbi mundësinë e një mekanizmi për stimulimin e grumbullimit të këtyre mbetjeve duke propozuar një stimul financiar prej 10 mijë lekë për ton, i cili do t'u shpërndahej grumbulluesve të tyre.

Gjithashtu, deputetët diskutuan për mundësinë e vendosjes së një kalendari për rritjen graduale të rentës së kromit me nga 1% përgjatë 3 viteve në vazhdim, duke krijuar një mundësi për rritjen e parashikueshmërisë së politikave fiskale për biznesin, dhe nxitjen e investimeve brenda vendit.

Gjatë shqyrtimit nën për nen të projektligjit, Komisioni vendosi:

1. Në nenin 2, në pikën 3 që ndryshon pikë 8 bëhen ndryshimet si më poshtë:

- a) Pika 8, fjalia e parë ndryshon si vijon: “8. Taksa e materialeve/artikujve plastikë dhe e ambalazheve plastike të importuara në kapitullin 39, të NKM-së, është 40 lekë/kg, me përjashtim të lëndëve të para në forma primare, të importuara në krerët 3901 deri në 3914, të NKM-së.”
- b) Në pikën 8.1 fjalët “25 lekë/kg” të zëvendësohen me fjalët “15 lekë/kg”;
- c) Pas pikës 8.4 të shtohet pika 8.5 si vijon: “8.5. Për ambalazhet plastike/qelqi të cilat eksportohen, dhe për të cilat taksa është paguar në momentin e importit/prodhimit të tyre, Administrata Doganore rimbursion shumën e taksës së paguar. Rimbursimi bëhet sipas procedurave të përcaktuara në Udhëzimin e Ministrit të Financave.”

2. Neni 6 të riformulohet si më poshtë:

“Neni 6

Në shtojcën nr.2, “Renta minerare sipas klasifikimit”, në grupin I, “Mineralet metalike”, në pikën 4, “Mineralet e kromit për eksport”, përqindja e rentës minerare bëhet 7 % duke filluar nga data 1 janar 2020, 8% duke filluar nga data 1 janar 2021, dhe 9% duke filluar nga data 1 janar 2022.”

- 3.** Gjithashtu, komisioni sugjeron që me pranimin e ndryshimit të nenit 6, të shihet edhe pika 1 e nenit 2 të projektligjit e cila lidhet me ndryshimin e raportit të përqindjes së rentës minerare për përmbajtjen e mineralit metalor në nënproduktin minerar që i referohet normës së rentës së grupit I, “Mineralet metalike”. Pra me pranimin e kalendarit të rritjes së rentës së kromit duhet të shihet edhe ky raport me qëllim që të mos afektohen nënproduktet minerare.

Ilir BEQAJ

Eduard SHALSI

Relator

Kryetar